

ILIRIAN MARTIRI

**ZGJEDHJA DHE PËRDORIMI LIGJËRIMOR I SINONIMISË
SINTAKSORE**

Në studime të natyrave të ndryshme për gjuhën shqipe një vend më vete zënë edhe trajtime të llojeve të ndryshme të sinonimisë. Ndër të tjera, studiuesit kanë tërhequr vëmendjen edhe për probleme të sinonimisë sintaksore. Duke iu referuar çështjeve të sinonimisë në kuadrin e sintaksës, prof. Mahir Domi ka vënë në dukje shfrytëzimin më të saktë e më të mirë të sinonimisë sintaksore në dobi të procesit të intelektualizimit të mëtejshëm të gjuhës, për t'iu përgjigjur kërkesave gjithnjë e më të thella të shoqërisë, duke shtuar kësisoj fuqinë e mundësitë shprehëse të saj¹. Ndërkohë, dihet se zhvillimi në fushën e gjuhës shprehet nga ana sasiore nëpërmjet shtimit të mjeteve të ndryshme shprehëse. Në këtë mënyrë, një faktor zhvillimi në fushën e sintaksës përbën shtimi sasiore i mjeteve shprehëse gjuhësore në perspektivat e pasurimit me mjete shprehjeje dhe kuptime të reja, të krijimit të lidhjeve të reja të fjalëve në fjali, të shtimit të marrëdhënieve të ndryshme sintaksore në shumëllojshmëri, duke sjellë si rrjedhim rritjen e mundësive shprehëse të gjuhës. Pikërisht për këtë arsye, rritja sasiore sjell si rezultat të natyrshëm rritjen cilësore, përsosjen e sistemit sintaksor të gjuhës². Kështu, sinonimia sintaksore mund të vështrohet jo vetëm në rrafshin e përmbajtjes, por edhe në atë të shprehësisë³.

Prof. Jani Thomai, duke depërtuar më thellë në ndriçimin e konceptit të sinonimisë, e vë theksin në ekzistencën e lidhjeve të barazisë ndërmjet njësive me kuptim të njëjtë, si dhe të lidhjeve të ngjashmërisë

¹ Domi, M. "Dukuri të zhvillimit të strukturës sintaksore të gjuhës sonë letrare të sotme", *Studime filologjike*, nr. 4, Tiranë, 1984, f. 60; "Dukuri e prirje të zhvillimit të strukturës sintaksore të shqipes së sotme letrare" *Gjuha jonë*, nr. 1, Tiranë, 1985, f. 49-50.

² S. Mansaku, "Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare". *Gjuha jonë*, nr. 1, Tiranë, 1985, f. 133.

³ S. Mansaku, po aty, f. 137.

ndërmjet njësive me kuptim të afërt⁴, duke theksuar se te sinonimet ekzistojnë lidhje kuptimore barazie dhe afrie⁵. Koncepti i sinonimisë përkufizohet gjithashtu si “ngjashmëri ... e ndërtimeve të ndryshme nga kuptimi” (FGJSSH, 1980), si “marrëdhënie (relacion) mes dy ... shprehjeve sinonime” (Micro Robert, Paris, 1977). Ndërsa në botimin e vitit 1988 të “Fjalorit të mendimit modern” koncepti i sinonimisë (i përdorshëm në fushën e gramatikës dhe në atë të semantikës) lidhet me konceptin e variacionit të lirë në gjuhësi, që ka të bëjë me marrëdhënien mes njësive gjuhësore të cilat kanë të njëjtën shpërmdarje, duke qenë të ndryshme në formë, por jo në këtë mënyrë të ndryshme në kuptim, pra, shihet se ekzistojnë njësi që nuk kontrastojnë, gjithmonë në kuadrin e së njëjtës gjuhë⁶. Rrjedhimisht, në sintaksë dy a më shumë ndërtime janë sinonimike kur, megjithëse paraqesin struktura sintaksore të ndryshme, shprehin të njëjtën përmbajtje kuptimore me ngjyrim të veçanta që lidhen me stilin, me nivelin e ligjërimit, me rrethanat ligjërimore etj⁷. Studiuesi Xhevat Lloshi thekson se një gjuhë letrare e lëvruar ka edhe një sistem të ndërlikuar sinonimesh e mënyrash sinonimike që përdoren sipas rastit, për ta dhënë mendimin me një hijezim tjetër kuptimor, për të dalluar anë më të holla ose për ta saktësuar përshkrimin⁸. Sinonimia merret këtu në kuptimin e gjerë, si sinonimi e mjeteve dhe mënyrave ligjërimore, për të dhënë po atë kuptim, duke u dalluar nga ngjyrimet dhe informacioni plotësues⁹. Nga pikëpamja stilistikës gjuhësore, stili është, ..., zgjedhja ndërmjet mënyrave sinonimike për ta shprehur po atë mendim, përmbajtje a kuptim¹⁰.

Në këtë perspektivë, synimi i përbashkët i palëve në ndërveprimin gjuhësor e jetësor konsiston në shkëmbimin dhe në përthithjen e plotë të mesazheve të ndërsjella, në mënyrë që të realizohet marrëveshja e

⁴ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2002, f. 137-138.

⁵ J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, SHBLU, Tiranë, 2002, f. 137-138.

⁶ *The Fontana Dictionary of Modern Thought*, second edition, Fontana Press, GB.

⁷ S. Mansaku, “Rreth sinonimisë sintaksore në shqipen e sotme letrare”. *Gjuha jonë*, nr. 1, Tiranë, 1985, f. 133.

⁸ Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, ShB. Toena, Tiranë, 1999, f. 134.

⁹ Xh. Lloshi, *po aty*, f. 34.

¹⁰ Xh. Lloshi, *po aty*, f. 9-11.

pritshme dhe të arrihen rezultatet e dëshiruara. Dhe natyrisht, rëndësia e përbërësve semantikë të strukturimit gjuhësor të mesazheve që shkëmbehen është në lidhje të drejtpërdrejtë me qëllimin kumtuesor të përdorimit gjuhësor. Duke iu referuar edhe traditës çomskiane, performancat e këtyre varianteve kumtimore në situatat përkatëse komunikative përbëjnë shprehje të kompetencës gjuhësore të përdoruesit gjuhësor. Duhet pasur parasysh se dallimet mes kumtimeve të ngjashme, të shprehura me variante sintaksore që janë sinonimike me njëri-tjetrin, hasen në aspektin vendor, kohor, situativ etj., të përdorimeve përkatëse ligjërimore. Me këtë rast, për arsye studimore duhet pranuar marrëveshja: një kumtim në një variant sintaksor = një përdorim gjuhësor). Çdo kumtim i shprehur nëpërmjet një varianti sintaksor të caktuar paraqet vlerat e veta në aspektin komunikativ. Këto vlera janë të krahasueshme me ato të një varianti tjetër të mundshëm kumtimor sinonimik me të parin.

Më konkretisht, vëmendja përqendrohet në truallin e sinonimisë sintaksore mes sintagmave emërore me emra veprimi me prapashtesën *-im* dhe sintagmave foljore me folje prej të cilave e kanë prejardhjen këta emra, brenda mundësive që ofron zbatimi i metodës studimore krahasuese për shqyrtimin e sferës së përdorimeve të mundshme gjuhësore, mbi bazën e zgjedhjeve përkatëse që arrin të bëjë përdoruesi i gjuhës shqipe, duke u pozicionuar në variantet e ngjashme ligjërimore për të kumtuar një përmbajtje të caktuar. Për një ndriçim më të plotë të kuadrin të dukurisë së marrë në shqyrtim, duke iu referuar vëllimit të parë të botimit të gramatikës shqipe të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, lidhur me formimin e emrave të veprimit, vihet në dukje se prapashtesa *-im* u shtohet temave foljore më *-oj* dhe *-ej* në kohën e tashme dhe, si rezultat, realizohet formimi i emrave të veprimit në gjininë mashkullore. Për më tepër, në gjendjen e sotme të gjuhës shqipe ekziston mundësia e arritjes së formimit të emrave abstraktë prejfoljorë të veprimit më *-im* pothuajse nga çdo folje më *-oj*. Kështu, prapashtesa *-im* paraqet një prodhimtari të konsiderueshme veçanërisht në gjuhën letrare¹¹. Në këtë

¹¹ *Gramatika e gjuhës shqipe 1, Morfologjia*. Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 140-142; E. Hysa, *Formimi i emrave me ndajshtesa në gjuhën shqipe*, Botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2004, f. 108-116; E. Hysa, “Vëzhgime rreth formimit të emrave me ndajshtesa”, *SF*, Tiranë, 2002, nr. 1-2; L. Buxheli, “Emrat e veprimit me prapashtesat **-im** dhe **-je**” *SF*, nr. 4, Tiranë, 1981; L. Buxheli, “Rreth

perspektivë, të dhëna të tilla shkencore integrohen në kuadrin e njohjes së mekanizmit të sistemit gjuhësor të shqipes nga ana e përdoruesit të saj. Njohja teorike dhe praktika e vazhdueshme e zbatimit të të dhënave të tilla shkencore ushtrojnë nga ana e tyre ndikim të drejtpërdrejtë në afirmimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të kompetencës gjuhësore të përdoruesit të shqipes. Zbatimi i një norme të tillë fjalëformuese (formimi i emrave të veprimit më *-im* thujse nga çdo folje më *-oj*) përbën për përdoruesin e gjuhës shqipe një zgjerim të sferës së përdorimeve sintaksore sinonimike me njëri-tjetrin. Përdorimi i rregullt i tyre si performancë në pajtim me situatat përkatëse jetësore, duke gjetur shprehjen e duhur në bazë të variacioneve ligjërimore stilistike funksionale, përbën dëshmi të një kompetence gjuhësore serioze nga ana e përdoruesit të shqipes. Praktika dhe depërtimi gjithmonë e më në thellësi të mekanizmit gjuhësor të saj bën që përdorimi i kësaj gjuhe nga ana e një individi me interesa të gjera jetësore të jetë shprehje e një kompetence gjuhësore në rritje dhe, si i tillë, të jetë dëshmi e një strategjie komunikative gjithmonë e më të përpunuar dhe më të përditësuar. Kështu, arrihet në një mbulim të mëtejshëm të sferës së përdorimit gjuhësor, me mundësi zgjedhjeje sipas kushteve dhe rrethanave jetësore. Për më tepër, një operacion i tillë (formimi i emrave të veprimit më *-im* thujse nga çdo folje më *-oj*) në brendësi të mekanizmit të tij gjuhësor, e ndihmon përdoruesin e shqipes të priret drejt formave të tjera të përdorimit gjuhësor, në performanca bindëse logjike, duke respektuar brenda mundësive kufijte e sinonimisë sintaksore, duke pasur parasysh interesat e tij komunikative, si dhe njohjen e kuadrit jetësor në bazë të përvojave. Dhe jo më kot, dinamika jetësore dhe dinamika e përdorimit gjuhësor janë në përpjesëtim të drejtë me njëra-tjetrën.

Për të përfutuar variante kumtimore sintaksore sinonimike me njëri-tjetrin, në rastin konkret kur kemi të bëjmë me një fjali/periudhë të vjelë nga letërsia artistike, në të cilën vërejmë përdorimin e një emri veprimi me prapashtesën *-im* dhe duam të gjejmë një variant tjetër sinonimik të kësaj fjalie/periudhe, është i mundshëm realizimi i procesit të zëvendësimit mekanik të emrit të veprimit më *-im* me foljen prej së cilës është formuar ky emër, duke përfutuar në këtë mënyrë një sintagmë të re

formimeve paralele me prapashtesat **-im** dhe **-je** në shqipen e sotme letrare”, *Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit*, Tiranë, 1986.

foljore në vend të sintagmës me emër veprimi dhe, ndërkohë, vlerat kuptimore arrihet të bëhen evidente vetëm nëpërmjet krahasimit të variantit bazë (originalit) dhe atij të përfutur (transformimit). Në sintaksë ka mjaft herë sinonimi elementesh, ndërtime e njësisish sintaksore. Ndër to, disa janë shprehëse më të qarta, përfaqësuese më tipike të një raporti sintaksor, ndërsa njësi të tjera janë më pak të qarta, jo aq tipike¹². Në rrafshin sintaksor, fjalitë dallohen sipas përbërjes së tyre dhe sipas llojit të kuptimit... Ato kanë marrëdhënie sinonimie, d.m.th., ekziston mundësia të zëvendësohet një lloj fjalie me një tjetër, duke ruajtur semantikën e përgjithshme, por me hijezime në rrafshin e kuptimit sintaksor¹³. Shpesh zëvendësimi me fjalë të tjera nuk është vetëm punë e kulturës së të shkruarit, sepse emërtimi i tjetërlojtë bën që sendi ose dukuria të shfaqet tashmë nga këndvështrime të ndryshme, duke prekur edhe tonin ose natyrën e përshkrimit¹⁴. Për më tepër, dëgjuesi ose lexuesi e percepton sinoniminë jo nga teksti, por nga përvoja e tij gjuhësore, që do t'i kërkonte fjalën tjetër po në atë pozicion¹⁵.

Më tej preken çështje të sinonimisë sintaksore mes varianteve ligjërimore me emra veprimi më *-im* dhe varianteve ligjërimore me folje prej të cilave janë formuar këta emra, ku duhet pasur parasysh se folje të tilla gjenden të pozicionuara në vend të emrave përkatës të veprimit në variante ligjërimore tashmë të transformuara. Sinonimia mes këtyre varianteve ligjërimore arrihet të perceptohet në rastet kur dy ose më shumë njësi të kësaj natyre kanë kuptime objektive të afërta ose të njëjta, pa harruar edhe forcën shprehëse dhe ngjyrimin emocional të njëjtë. Por në një përdorim serioz të tyre në përputhje me situatat ligjërimore në kushtet dhe rrethanat reale një rol të rëndësishëm luan zgjedhja e duhur ligjërimore e kryer nga individ i përdorues i gjuhës, në përputhje me realitetin gjuhësor e objektiv, e shprehur në çdo rast në pajtim me normën standarde në komunikim. Le të shohim më poshtë një model shqyrtimi:

¹² Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, *Gramatika e gjuhës së sotme shqipe II – Sintaksa*, Tiranë, 2002, f. 54-55.

¹³ Xh. Lloshi, *Stilistika dhe pragmatika*, ShB. Toena, Tiranë, 1999, f. 134.

¹⁴ Xh. Lloshi, po *aty*, f. 134.

¹⁵ Xh. Lloshi, po *aty*, f. 136.

origjinali - *Po në qëndroftë Tyrqia e të ngulnjë këmbët në këtë udhë që ka zënë duke rungullizunë në trapt të humbjesë, e të mos dojë shpëtimn' e saj sindëkur e ka zakon, atëherë Shqipëtarët shpëtojnë vetë vetëhenë, e nukë humbasin' edhe ata bashkë me këtë të-marrë, që po vret vetëhenë, duke pasurë në dorë të shpëtonjë, si e di gjithë bota.* (S. Frashëri, "Shqipëria ç'ka qenë, ç'është dhe ç'do të jetë", bot. VI, ShB Luarasi, Tiranë, f. 66.)

- transformimi: *Po në qëndroftë Tyrqia e të ngulnjë këmbë në këtë udhë që ka zënë duke rungullizunë në trapt të humbjesë e të mos dojë të shpëtojë vetëhenë, sindëkur e ka zakon, ...*

Duke marrë në shqyrtim këtë rast, vihet re se emri më *-im* (tek origjinali) zëvendësohet me foljen prej së cilës është formuar. Kjo folje është në diatezën veprorë, në kohën e tashme të mënyrës lidhore (siç shihet te transformimi). Kundrinori i drejtë i njëres fjali të nënrenditur kushtore, që lidhet me dy fjalitë e tjera kushtore me lidhje bashkërenditëse, shndërrohet në rastin tonë në kallëzues të një fjalie të re të varur kundrinore, që i nënrenditet fjalisë së mëparshme, pjesë e së cilës ishte kundrinori i drejtë i shndërruar. Nga transformimi preken edhe gjymtyrë të tjera të fjalisë. Përcaktori me përshtatje i kundrinorit të drejtë *e saj*, i shprehur me përemër pronor, shndërrohet në kundrinor të drejtë të shprehur me përemër vetvetor *vetëhenë*. Gjithashtu, ndodhin ndryshime edhe në skemën e përgjithshme strukturore të periudhës. Lind një fjali e re e varur kundrinore, që i nënrenditet fjalisë kushtore, sipas trajtimit të mësipërm. Duke trajtuar më konkretisht veçoritë semantike, vihet re se në modelin e origjinalit, në kuadrin e një veprimi të kushtëzuar, nëpërmjet emrit të veprimit më *-im*, autori synon që përqendrimi i lexuesit të jetë te dukuria e përcaktuar si një destinacion përfundimtar, me tërësinë e saj konceptuale, ndërsa në modelin e transformimit vihet re folja-kallëzues e një fjalie të re të varur, që shpreh alternativën e kryerjes së veprimit në një rrjedhë të caktuar kohore, në mënyrë që përfundimi të perceptohet si rezultat i punës së kryer. Nëpërmjet transformimit të strukturës së periudhës së marrë në shqyrtim kemi përfutur një variant të ri përdorimi të kësaj periudhe, sinonimik me të parin. Varianti i ri i përfutur si pasojë e transformimit vërehet në nivel sintaksor dhe, në një kuadër më të përgjithshëm, është rezultat i drejtpërdrejtë i zëvendësimit të një trajte/ndërtimi me një trajtë ose ndërtim tjetër sintaksor, të

vlerësuar si të barasvlershëm me rastin e parë¹⁶. Në këtë mënyrë hapet rruga drejt atyre performancave që përbëjnë shprehje të përdorimeve të ndryshme gjuhësore sinonimike me njëri-tjetrin, si dhe të zgjerimit të së njëjtës sferë përdorimi, drejt realizimit të synimeve komunikative gjithmonë e më të shtrira në hapësirë dhe kohë, në një mbulim gjithmonë e më të plotë të realitetit. Le të vijojmë me një shembull tjetër:

- origjinali: *U qetësua nga mendimi se duke qenë në një gjendje gati delirante, tjetri s'do të mbante mend asgjë më pas.* (I.Kadare, "Lulet e ftohta të marsit", v. 2000, f. 50.)

- transformimi: *U qetësua pasi mendoj se duke qenë në një gjendje gati delirante, tjetri s'do të mbante mend asgjë më pas.*

Siç shihet edhe në këtë rast, emri i veprimit më *-im* mund të zëvendësohet me foljen prej së cilës është formuar, në kohën e kryer të thjeshtë. Kështu, rrethanori i shkakut i fjalisë kryesore shndërrohet në kallëzues të fjalisë së re të varur shkakore, siç rezulton në fakt në transformim, ku në periudhën e re vihen re gjithashtu elemente të kuptimit kohor. Me këtë rast shtohet lidhëza *pasi* dhe bie parafjala *nga*. Veç këtyre ndryshimeve, gjymtyrët e tjera mbeten siç ishin në origjinal, por ndodhin ndryshime në skemën e përgjithshme strukturore të periudhës, së cilës i shtohet një fjali e re e nënrenditur shkakore, por me kuptim kohor. Në materialin e vjelë në origjinal përdorimi gjuhësor konsiston në një theksim më të ndjeshëm të konfigurimit të gjendjes. Këtu teksti zotëron tipare të ligjërimit të shkruar. Ndërkohë, transformimi bën të duket më konkret përdorimi gjuhësor me tipare të ligjërimit të folur. Më konkretisht, në modelin e origjinalit procesi paraqitet si një tërësi e përfunduar, ndërsa në modelin e transformimit konstatohet procesi në rrjedhën e tij drejt realizimit gjatë një intervali kohor. Rrjedhimisht, periudha e re e përfutur (transformimi) i përgjigjet një përdorimi të ri gjuhësor, në krahasim me periudhën origjinale, pasi lejon të përqendrohet vëmendja e përdoruesit të shqipes në vlera të tjera të reja të veçanta semantike, përveç vlerave thelbësore që i ka të përbashkëta me periudhën origjinale. Një linjë e tillë e përdorimit gjuhësor, e krijuar rishtazi në rastin tonë, ndonëse njihet ekzistenca e saj potenciale për shkak të mekanizmit të sistemit gjuhësor të shqipes, dëshmuar në

¹⁶ *Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 54-55.

përdorime të tjera ligjërimore në situata jetësore nga më të ndryshmet, bën të zbulohet një shtrirje dhe dimensionim i mëtejshëm në hapësirë dhe në kohë i fushës së përdorimit gjuhësor, vetëm nëpërmjet një krahasimi semantik të kryer mes sintagmash sinonimike me njëra-tjetrën. Gjithsesi, duhet theksuar se në të njëjtat rrethana jetësore, ose në rastet përkatëse ku kërkohet përdorimi i veçantë i secilës prej tyre në varësi dhe në përputhje me situatën ligjërimore përkatëse, pa llogaritur këtu alternativat e përdorimit të tyre jashtë situatave reale, përdorimi i periudhës së marrë në shqyrtim, qoftë kjo në formën e saj origjinale apo në atë të transformuar, nuk sjell të njëjtat rezultate, siç u pa edhe më sipër. Për një parashtrim të vlerave lidhur vetëm me aspektin semantik, duke paraqitur më vete fillimisht sintagmat emërore me emra veprimi më *-im* rezultojnë:

(1) - *Kohët e fundit, qyshse në kokën e tij, në mënyrën më bardhezi, ishte ngulur mendimi se gjithçka e saj lidhej tashmë me të ardhmen, kurse çdo gjë e tij, përkundrazi, rëndonte nga e shkuara, biseda të tilla e trembnin.* (I.Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, v. 2000, f. 17.)

(2) - *U qetësua nga mendimi se duke qenë në një gjendje gati delirante, tjetri s’do të mbante mend asgjë më pas.* (I.Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, v. 2000, f. 50.)

(3) - *Asgjë në botë nuk e kishte pritur me aq padurim e ankth sa mesnatën e ditës së nesërme. Herë-herë, tek kapte vështrimin e gjarprit e humbte shpresën.* (I.Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, v. 2000, f. 32.)

(4) - *Talaat beu u hoq, se bëri shumë gabime në Shqipëri, në Siri e në Arabi.* (F.Noli, “Vepra 2” (1905-1925), v. 1988, f. 377.)

(5) - *Po në qëndroftë Tyrqia e të ngulnjë këmbët në këtë udhë që ka zënë duke rungullizunë në trapt të humbjesë, e të mos dojë shpëtimin’ e saj sindëkur e ka zakon, atëherë Shqipëtarët shpëtojnë vetë vetëhenë, e nukë humbasin’ edhe ata bashkë me këtë të-marrë, që po vret vetëhenë, duke pasurë në dorë të shpëtonjë, si e di gjithë bota.* (S. Frashëri, “Shqipëria ç’ka qenë, ç’është dhe ç’do të jetë”, bot. VI, ShB Luarasi, Tiranë, f. 66.)

Strukturat sintaksore që kanë në përbërje të tyre emra me prapashtesën *-im* u përgjigjen në një mënyrë më të drejtpërdrejtë dhe më cilësore kërkesave komunikative për një paraqitje sa më përgjithësuese, sintetike dhe koncize të mesazheve filozofike, të dukurive natyrore, psikologjike, shoqërore dhe morale. Shprehja e kuptimit të rezultatit nëpërmjet strukturave të tilla paraqitet në mënyrë të drejtpërdrejtë, në

pajtim me parimet e ekonomisë gjuhësore. Në to spikat paraqitja e një karakteri më intelektual të veprimit. Sidomos nëpërmjet tyre veprimi paraqitet pikërisht në konkretësinë dhe identitetin e tij të plotë, me të gjitha karakteristikat bazë, si dukuri objektive e përcaktuar dhe e përgjithësuar, pavarësisht nga individët që e kryejnë atë, nga tiparet dhe karakteristikat e tyre psikologjike, si tipare të identitetit individual e shoqëror dhe nga masa se sa i përmbahen ata procesit të përcaktuar. Nëpërmjet sintagmave të tilla emërore arrihet të integrohen në një vizioni, veprimi dhe rezultati, pasi integrimi, sintetizimi i kuptimeve të fillimit, vazhdimit dhe përfundimit të procesit përbëjnë tashmë fakte të njohura. Në raport me sintagmat foljore, ato me emra veprimi të prejardhura prej foljeve përkatëse realizojnë vetëdijesim jo vetëm për paraqitjen e veprimit, por edhe për atë të procesit, për më tepër duke u ngritur edhe në nivelin e termit. Aq më e fortë spikat kjo dukuri, sa më shumë të arrihet drejt një përqendrimi në vetvete të një numri gjithmonë e më të madh elementesh kuptimore në brendësi të një hapësire fizike sa më të kufizuar të shkrimit, si shprehje e ekonomisë gjuhësore. Nga ana tjetër, në sintagmat foljore te modelet alternative (në krahasim me ato përkatëse emërore tek origjinalet)

- transformë (1): ... mendonte se gjithçka e saj lidhej tashmë me të ardhmen, kurse ...

- transformë (2): U qetësua pasi mendoj se duke qenë në një gjendje gati delirante, tjetri s' do të mbante mend asgjë më pas.

- transformë (3): Herë-herë, tek vështronte gjarprin e humbte shpresën.

- transformë (4): Talaat beu u hoq se gaboj shumë në Shqipëri, në Siri e në Arabi.

- transformë (5): Po në qëndroftë Tyrqia e të ngulnjë këmbë në këtë udhë që ka zënë duke rungullizunë në trapt të humbjesë e të mos dojë të shpëtojë vetëhenë, sindëkur e ka zakon, ...

vihet re se shkohet drejt shuarjes së atyre tipareve stilistike të konstatuara në modelet e vjela, të paraqitura sipas origjinalit. Vihet re prirja drejt një pranie tiparesh karakteristike për ligjërimitin e folur, edhe pse mund të jenë pjesë e një materiali të shkruar me tipare karakteristike letraro-artistike. Konstatohet prirja drejt një karakteri më analitik të shprehësisë. Veprimi paraqitet më i ngadalshëm dhe, si rrjedhim, më i perceptueshëm në rrjedhën kohore, duke mos u vendosur në dinamikën absolute të tij, si në modelet origjinale me ndërtimet emërore. Në

sintagmat foljore të përftuara spikat roli i individit në kryerjen e një veprimi të caktuar brenda kuadrit të një intervali të përcaktuar kohor. Veprimi paraqitet gjatë procesit të tij të kryerjes, kur është ende i papërfunduar, por kjo fazë e përfundimit mund të supozohet si e tillë. Nëpërmjet shmangies së termave ose të elementeve me prirje drejt terminologjisë, duke i zëvendësuar ato me sintagma foljore, në funksion të një zgjedhjeje tjetër për përdorim gjatë procesit të komunikimit, me synimin për të afirmuar vlera të tjera komunikative veç atyre ekzistueseve, nuk arrihet të mundësohet sa duhet paraqitja e kompetencës profesionale, pasi nëpërmjet sintagmave foljore është e mundur të paraqiten zgjidhje praktike të çastit vetëm në një hapësirë të kufizuar. Këto zgjidhje mund të jenë edhe tepër të veçanta, në përputhje madje vetëm me një situatë konkrete ligjërimore, larg vlerës përgjithësuese që mund të kërkohet në situata të tjera komunikative.

Përveç këtyre problemeve, nuk duhet lënë pa përmendur edhe një aspekt tjetër i rëndësishëm që lidhet me funksionin e këtyre zëvendësimeve, transformimeve dhe përdorimeve si shprehje e performancave gjuhësore në fushën e shqipes. Vënia në zbatim e teknikës së zëvendësimit të një shprehjeje ose dukurie që shfaq elemente paqartësie me një shprehje tjetër më të qartë¹⁷ duket se është më e përshtatshme të përdoret në fushën e mësimdhënies së shqipes. Në shembullin që vijon

- origjinali: *Asgjë në botë nuk e kishte pritur me aq padurim e ankth sa mesnatën e ditës së nesërme. Herë-herë, tek kapte vështrimin e gjarprit e humbte shpresën.* (I. Kadare, “Lulet e ftohta të marsit”, v. 2000, f. 32.)

- transformimi: *Herë-herë, tek vështronte gjarprin e humbte shpresën.*

nëpërmjet dy performancave (në origjinal dhe në transformim) vihet re qartë dallimi në nivelin e kompetencës gjuhësore: zotërimi i figuracionit artistik të fjalës, ndonëse nga pikëpamja kumtimore të dy variacionet ligjërimorë janë të pranueshëm. Megjithatë dallohet përdorimi artistik i fjalës nga ai i përgjithshmi. Në këtë mënyrë, synohet në nxitjen e një manovrimi në brendësi të mekanizmit gjuhësor të cilitdo

¹⁷ *Gramatika e gjuhës shqipe 2, Sintaksa*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë, 2002, f. 54-55.

individ, në ndjekjen e një kursi të një niveli të caktuar lidhur me përvetësimin e shqipes, me qëllim që mësimet që merr, t'i vërë në funksion të një përdorimi më të mirë të saj, që nëpërmjet komunikimit të tij t'i përgjigjet më mirë ndriçimit të situatës komunikative duke realizuar performanca bindëse, në përputhje me synimet komunikative dhe jetësore të tij, gjithmonë e më shumë si përdorues i kualifikuar i gjuhës shqipe.

Të dhënat e mësipërme përbëjnë parametra gjuhësore në funksion të zgjedhjes së duhur ligjërimore, në përputhje me situatat jetësore ku nevojitet përdorimi i njërit apo tjetrit variacion gjuhësor, si dhe me synimet komunikative të përdoruesit të shqipes. Duke përfunduar, veç çështjeve të dinamikës së komunikimit në tërësi, çështjeve të perspektivës fjalëformuese folje – emër veprimi më *-im* në komunikim dhe zëvendësimit mekanik si proces në një pikë të caktuar të një fjalie të dhënë, si dhe transformimit tërësor të kësaj fjalie si një variant i ri përdorimi sinonimik me fjalinë e mëparshme, duhet vënë në dukje se çështjet e sinonimisë mes ndërtimeve sintaksore me emra veprimi më *-im* dhe atyre me folje prej të cilave janë formuar emrat përkatës mund të shqyrtohen gjithashtu duke pasur parasysh edhe parametrat morfosintaksorë të përdorimeve gjuhësore të kësaj natyre. Një linjë tjetër studimore mund të zërë fill duke u nisur nga aspektet e variacionit të tyre ligjërimor – stilistik, në një kuadër gjithmonë e më të zgjeruar të semantikës sintaksore.

SUMMARY

THE SELECTION AND THE SPEECH USAGE OF SYNTACTIC SYNONYMS IN ALBANIAN LANGUAGE

In this study is presented some linguistic aspects of synonymous rapports between nominal phrases composed by nouns with the suffix *-im* and verbal phrases, from the point of view of syntax, stylistics and semantics, when the processes of choice and usage of language are possible. The examples are taken from artistic and publicistic literature. There are a number of references to different scholars of linguistic studies from Albania and other countries. The examples when it is possible to replace an action noun with suffix *-im* (in composition of a nominal phrase) with a verb linked semantically with the respective action, transforming the nominal phrase into a synonymous verbal phrase are treated from a comparative method in order to know about the same

elements of meaning and the different elements of meaning between two synonymous phrases. The aim is to give the examples of preservation of possibly all the units of meaning into synonymous phrases, for the best choice and the best usage of language, for a loyal information and communication, for all the communicational needs of the Albanian speaker and the Albanian society.